VENDIM
Nr.451, datë 9.7.2004

PËR KRITERET DHE MASËN E TRAJTIMIT FINANCIAR TË USHTARAKUT AKTIV TË FORCAVE TË ARMATOSURA, KUR LIROHET NGA SHËRBIMI NË KËTO FORCA PËR ARSYE SHËNDETËSORE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 29 të ligjit nr.9210, datë 23.3.2004 "Për statusin e ushtarakut të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë", me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ushtaraku aktiv i Forcave të Armatosura, kur sëmuret në detyrë ose për shkak të detyrës, dhe kur vërtetohet me raport të Komisionit të Lartë Mjekësor të Spitalit Universitar Qendror Ushtarak, lirohet nga shërbimi në Forcat e Armatosura dhe përfiton trajtim financiar deri në punësimin e tij ose në daljen në pension të plotë pleqërie.

2. Të drejtën e trajtimit sipas këtij vendimi e kanë ushtarakët që kanë vjetërsi shërbimi jo më pak se 3 (tre) vjet në këto Forca dhe trajtohen me pagën bazë për gradë, si më poshtë vijon:

a) Oficerët trajtohen me pagën bazë për gradë të nëntogerit, me vite shërbimi nën 2 vjet;

b) Nënoficerët trajtohen me pagën bazë për gradë të nëntetarit, me vite shërbimi nën 2 vjet;

c) Ushtarët profesionistë trajtohen me pagën bazë për gradë të ushtarit profesionist I, me vite shërbimi nën 2 vjet.

3. Ushtaraku e përfiton këtë pagë deri në rastin e punësimit ose të plotësimit të kushteve për pension të parakohshëm për vjetërsi shërbimi apo pensioni pleqërie. Pagesa të bëhet pranë reparteve ushtarake, ku ushtaraku ka kryer shërbimin.

4. Ky trajtim financiar ndërpritet nëse ish-ushtaraku refuzon vendin e punës që i ofrohet nga zyrat përkatëse të punës dhe nëse deklarohet i aftë nga ana mjekësore, nga Komisioni Mjekësor i Lartë në Spitalin Universitar Qendror Ushtarak.

5. Ushtaraku ka të drejtën e zgjedhjes ndërmjet këtij trajtimi financiar dhe trajtimit me pagesë kalimtare, sipas nenit 10 të ligjit nr.8087, datë 13.3.1996 "Për sigurimin shoqëror suplementar të ushtarakëve të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, të Ministrisë së Rendit Publik, Shërbimit Informativ Shtetëror dhe të ish-Ministrisë së Brendshme", të ndryshuar.

6. Periudha e trajtimit financiar, në zbatim të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993 "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, quhet periudhë sigurimi. Kontributet për sigurimin shoqëror të këtyre ushtarakëve të përballohen nga fondet e miratuara për Ministrinë e Mbrojtjes.

7. Personat përfitues të këtij trajtimi financiar duhet t'i nënshtrohen një herë në vit rivlerësimit mjekësor nga Komisioni Mjekësor i Lartë në Spitalin Universitar Qendror Ushtarak.

8. Efektet financiare për vitin 2004, që arrijnë shumën 2 400 000 (dy milionë e katërqind mijë) lekë, të përballohen nga buxheti i këtij viti, miratuar për Ministrinë e Mbrojtjes.

9. Ngarkohen Ministri i Mbrojtjes dhe Ministri i Punës dhe i Çështjeve Sociale për nxjerrjen e udhëzimit përkatës në zbatim të këtij vendimi.

10. Pika 2 e vendimit nr.86, datë 12.3.1992 të Këshillit të Ministrave "Për disa të drejta e detyrime të ushtarakëve, të cilat rrjedhin nga ligji "Për statusin e ushtarakut të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë"", shfuqizohet.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 1.7.2004.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano